



Kolegji AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

Fakulteti i Komunikimit Masiv – Gazetari

Niveli i studimeve Master

**NDIKIMI I DHUNËS NDAJ GAZETARËVE NË PUNËN
E TYRE PROFESIONALE
(ANALIZË E RASTEVE TË DHUNËS 2017-2021)**

Kandidatja:

Sebahate HAJREDINAJ

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Resul SINANI

Prishtinë, 2022

Abstrakt

Ky punim paraqet gjendjen e sigurisë së gazetarëve në Republikën e Kosovës duke studiuar rastet e dhunës fizike në periudhën kohore 2017-2021.

Punimi është mbështetur në dokumente ndërkombëtare për sa i përket kontekstit teorik që nga dokumentet e para sikurse Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut e vitit 1948, dhe dokumentet e tjera përmes së cilave secili shtet demokratik obligohet që përmes ligjeve të mbrojë lirinë e shprehjes, dhe rrjedhimisht të mbrojë edhe gazetarët të cilët raportojnë lidhur me dukuritë në shoqëri (Universal Declaration of Human Rights, 1948).

Republika e Kosovës ka një mori ligjesh të cilat janë në përputhje me ligjet e Bashkimit Evropian për sa i përket garantimit dhe mbrojtjes së lirisë së shprehjes.

Përkundër të gjitha ligjeve në fuqi të cilat mbrojnë gazetarët dhe punën e tyre, në Kosovë siguria e gazetarëve mbetet e brishtë. Duke parë situatën e përgjithshme dhe ndikimet e rrethanave të ndryshme si politike, ekonomike dhe sociale në Republikën e Kosovës, gazetarët sfidohen çdo ditë nga palë të ndryshme. Gazetarët në Kosovë ballafaqohen edhe me kushtet jo të volitshme të punës duke mos pasur mundësi që ta kryejnë misionin e tyre të shenjtë.

Sipas statistikave të ofruara nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), gjatë periudhës 2017-2021 janë evidentuar gjithsej 196 raste të kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve. Në vitin 2017 kanë ndodhur gjithsej 24 raste, në vitin 2018 janë regjistruar 17 raste, në vitin 2019 kanë qenë 19 raste, në vitin 2020, 24 raste, dhe në vitin 2021 janë regjistruar gjithsej 29 raste të kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve (AGK, 2017-2021). Përmes intervistave të thella me gazetarët të cilët janë kërcënuar dhe i janë nënshtruar çfarëdo lloj dhune, janë paraqitur 10 raste të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës 2017-2021. Këto raste janë përshkruar në detaje, duke nxjerrë në pah arsyen e kërcënimit apo sulmit fizik, dyshimin se nga kush janë kërcënuar, dhe ndikimin që e kanë pasur në punën e tyre profesionale.

Fjalë kyçe: Gazetar; Dhunë; Ndikimi i dhunës; Liria e medias; Liria e shprehjes; Censura.

Abstract

This research presents the security situation of journalists in the Republic of Kosovo by studying cases of physical violence in the period 2017-2021.

The paper is based on international documents in terms of theoretical context from the first documents the Universal Declaration of Human Rights 1948 and other documents, through which every democratic state is obliged by law to protect freedom of expression and consequently protect even journalists who report on phenomena in society (Universal Declaration on Human Rights, 1948).

The Republic of Kosovo has a number of laws which are in line with the laws of the European Union that guarantee and protect freedom of expression.

Despite all the laws in force which protect the journalist and his work, the safety of journalists in Kosovo remains fragile. Seeing the overall situation and the impact of different circumstances such as economic, economic and social policy in the Republic of Kosovo, journalists are challenged every day by different parties. Journalists in Kosovo also face unfavorable working conditions, not being able to carry out their sacred mission.

According to statistics obtained from the Association of Journalists of Kosovo (AJK), a total of 196 cases of threats and cases of violence against journalists have been identified. In 2017 a total of 24 cases, in 2018 17 cases were identified, in 2019 there are 19 cases, in 2020 there are 24, and in 2021 there are 29 cases of threats and violence against journalists (AJK, 2017-2021).

Through in-depth interviews with journalists who have been threatened and subjected to any kind of violence, 10 cases have been presented in the period 2017-2021. These cases are described in detail highlighting the reason for the threat, the suspicion of who threatened them and the impact they had on their professional work.

Keywords: Journalist; Violence; The impact of violence; Freedom of the media; Freedom of expression; Censorship.

DEKLARATË E AUTORËSISË

Përmbajtja e këtij punimi është tërësisht autoriale. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Deklaroj dhe marr përgjegjësi profesionale dhe morale se punimi im është punim autentik i punuar me përkushtim. Deklaroj se punimi është bazuar në intervista të gazetarëve, dhe është tërësisht autorial. Punimi nuk është i publikuar e as i përdorur për qëllime të kryerjes së obligimeve mësimore në ndonjë institucion arsimor.

Deklaroj se gjatë hartimit të këtij punimi, i kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të Kolegjit AAB.

Sebahate Hajredinaj

Prishtinë, më _____

@Copyright, Sebahate Hajredinaj 2022

FALËNDERIM

Kam kënaqësinë të shpreh mirënjohjen time për të gjithë ata që më dhanë mundësinë të kompletoj këtë punim.

Dëshiroj të shpreh mirënjohje të veçantë për mentorin tim të nderuar dhe të respektuar Prof. Ass. Dr. Resul Sinani, në Kolegjin AAB. Ligjëruesin frymëzues i cili gjatë studimeve master, me profesionalizëm të pakrahasueshëm hapi një horizont të ri të njohurive për studentët, posaçërisht të drejtimit të Komunikimit Masiv. Profesor Resul Sinani luajti rol të rëndësishëm në qasjen time ndaj këtij punimi, duke më udhëzuar në të gjitha fazat e punimit deri në përfundimin e tij. Ky punim nuk do të ishte i kompletuar pa mbikëqyrjen, sugjerimet dhe kujdesin e tij të veçantë gjatë të gjitha fazave të përgatitjes, prandaj i jam shumë mirënjohëse për përkushtimin dhe ndihmën e tij të vazhdueshme.

Falënderimet e mia më të thella janë për familjen time, bashkëshortin dhe katër fëmijët e mi: Anyla, Adea, Hana dhe Rron, përkrahja e të cilëve, mirëkuptimi dhe dashuria e pakusht e bëri më të lehtë këtë rrugëtim.

Dëshiroj t'i falënderoj edhe gazetarët dhe të gjitha palët e intervistuar, të cilët nuk hezituan të ndihmojnë, sugjerojnë, udhëzojnë dhe kontribuojnë në mbledhjen e informatave. Ata janë pjesë shumë e rëndësishme, dhe pa ndihmën e tyre ky punim nuk do të mund të realizohej.

HYRJE

Mediat janë shtylla e katërt e pushtetit dhe zhvillimit të demokracisë. Gazetarët janë në shënjestër të grupeve të interesit e politikës, dhe kjo e bën që ata të sulmohen dhe të dhunohen në mënyra të ndryshme, duke filluar nga kërcënimet në mënyrë verbale si dhe nga politika. Çdo kufizim i lirive individuale të gazetarëve, mediave ku ata punojnë apo komunitetit të cilit ata i takojnë, e minimizon autonominë dhe e kërcënon sigurinë e tyre. Argumenti kryesor qëndron në atë se raporti në mes të autonomisë së gazetarëve dhe sigurisë së tyre ndërlihet, dhe ato nuk funksionojnë njëra pa tjetrën (Carlsson et al, 2017).

Sipas punimit shkencor hulumtues të UNESCO-s, në botë çdo pesë ditë vritet nga një gazetar për shkak të shpërndarjes së informacionit tek publiku. Sipas po të njëjtit burim, këto sulme janë nga më të ndryshmet duke përfshirë vrasje, arrestime, linçime, në vende të ndryshme, kohë të ndryshme, arsye dhe qëllime të ndryshme, dhe në secilin nga rastet, gazetarëve ju rrezikohet jeta. Në shkrimin akademik (*Building knowledge to protect freedom of expression*) thuhet se të tjerët shpesh i shohin gazetarët si persona të cilët nuk e kryejnë punën siç duhet, duke mos i analizuar rrethanat dhe shkaqet që gazetarin e shtyjnë të raportojë në momente të caktuara (Carlsson et al, 2017).

Bazuar në raporte ndërkombëtare, Republika e Kosovës numërohet si vend me liri të kufizuar të shprehjes. Në publikimin e fundit të “Indeksit të Lirisë së Shtypit të Reporterëve pa Kufij”, për gjendjen e lirisë së mediave në Kosovë për vitin 2021, Kosova është renditur në vendin e 78-të në botë sa i përket lirisë së shtypit, dhe qëndron më mirë krahasuar me disa vende të rajonit. Megjithatë, rënia që ka pësuar Kosova për 8 vende në këtë renditje, dëshmon gjendjen reale jo të kënaqshme të lirisë së mediave në Kosovë. Sipas këtij indeksi, vendet e rajonit renditen si në vijim: Kosova, në vendin e 78-të, Serbia, 93, Bosnje dhe Hercegovina, 58, Maqedonia e Veriut, 90, Shqipëria, 83 dhe Mali i Zi, në vendin e 104.

Tabela 1

Reporterët pa Kufij – rangimi në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit
(0 – rezultati më i mirë i mundshëm; 100 - rezultati më i keq i mundshëm)

	Kosova	Serbia	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia e Veriut	Shqipëria	Mali i Zi
2021	78 ▼	93 ▼	58 ▼	90 ▲	83 ▼	104 ▲
2020	70	93	58	92	84	105
2019	75	90	63	95	82	104
2018	78	76	62	109	75	103
2017	82	66	65	111	76	106

Shënim: Tabela e punuar nga Sebahate Hajredinaj. Burimi: “Reporterët pa Kufij”, të Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit, renditja e Kosovës përgjatë viteve 2017-2021. Shigjetat e kuqe tregojnë rënie, ndërsa të kaltrat ngritje në renditjen globale të lirisë së shtypit. <https://rsf.org/en/country/kosovo>

Në përgjithësi, gjatë periudhës 2017-2021, gjendja e sigurisë së gazetarëve në Kosovë është përshkallëzuar. Gazetarët janë sulmuar në forma të ndryshme përmes frikësimit, linçimit publik, kërcënimeve verbale, sulmeve fizike dhe psikologjike, gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Këtë gjendje e verifikojnë edhe raportet e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), i cili ofron të dhëna në bazë vjetore lidhur me rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. Sipas këtyre të dhënave, në periudhën kohore nga viti 2017 deri në vitin 2021 janë evidentuar gjithsej 196 incidente, ku viktimat kanë qenë gazetarë dhe profesionistë tjerë të medias. Dhuna ndaj gazetarëve shfrytëzohet si mjet për t'i shtyrë ata të vetëcensurohen, të heshtin, ta ndërrojnë vendin e punës apo të merren me tema të cilat nuk prekin direkt persona apo çështje të ndryshme të cilat mund të paraqesin gjendje reale (AGK, 2021).

Në anën tjetër, liria e shprehjes është e drejtë themelore e cila mbrohet me Nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ajo mbrohet edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, Konventën Amerikane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa në Kosovë, liria e shprehjes garantohet me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Përkundër këtyre standardeve të cilat e mbrojnë fjalën e lirë në të gjitha shtetet me demokraci të zhvilluara, gazetarët në Kosovë akoma hasin në probleme të ndryshme kur raportimet e tyre kanë të bëjnë me tema të ndjeshme. Këtë gjendje e verifikojnë edhe raportet e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës "Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve" (2018, 2019, 2020, 2021) të cilat ofrojnë të dhëna në bazë vjetore lidhur me rastet e sulmeve ndaj gazetarëve (AGK, 2017-2021).

Sipas këtyre të dhënave, në periudhën kohore nga viti 2017 deri në vitin 2021, janë evidentuar gjithsej 196 incidente, ku viktimat kanë qenë gazetarët dhe profesionistët tjerë të medias. Në vitin 2017 janë regjistruar gjithsej 24 raste ku dy prej tyre kanë qenë sulme fizike

ndaj gazetarëve Jon Ahmeti dhe Parim Olluri. Në vitin 2018 janë evidentuar 17 raste, dy prej tyre sulme fizike ku janë sulmuar Blerim Uka dhe Serbeze Haxhiaj, gjatë vitit 2019 janë regjistruar 19 raste, ku dy nga këto raste janë sulme fizike ndaj gazetarëve Nora Kelmendi dhe Mejreme Gashi. Në vitin 2020 janë regjistruar 24 raste, ku dy prej tyre janë evidentuar si sulme fizike ndaj gazetarëve Valon Syla, dhe ekipit të portalit Arberesh.info. Gjatë vitit 2021 janë evidentuar 29 raste, dhe dy prej tyre kanë qenë sulme fizike ndaj gazetarëve Visar Duriqi dhe Albulena Rexhaj. Dhuna fizike dhe llojet e tjera të dhunës sipas rasteve të paraqitura kanë pasur motive të ndryshme (AGK, 2022).

Sipas raporteve ndërkombëtare siç janë Reporterët pa Kufij (RSF, 2021), Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën (Kosovo Report, 2021), Raporti i Freedom House për Kosovën (Freedom House, 2021), Republika e Kosovës ka kornizë të avancuar ligjore e cila promovon mbrojtjen e gazetarëve si një pjesë e rëndësishme e shoqërisë.

Përkundër kornizës së avancuar ligjore, gazetarët nuk kanë siguri të mjaftueshme edhe në vendet e punës, dhe janë të ndikuar nga pronarë biznesesh të cilët varen nga tregu i reklamës. Kjo bën që gazetarët të punojnë pa kontrata dhe me kushte të dobëta të punës, gjë e cila ndikon në vetëcensurim dhe frikë nga humbja e vendit të punës (AGK, 2021).

Qëllimi i hulumtimit

Punimi ka për qëllim të tregojë se si ka ndikuar dhuna dhe kërcënimet tek gazetarët në periudhën kohore 2017-2021, në Republikën e Kosovës. Ai ka për qëllim paraqitjen e këndvështrimit të dhunës ndaj gazetarëve, përmes intervistave të thella me afro dhjetë gazetarë që kanë përjetuar dhunë fizike gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Gjithashtu, punimi do t'i identifikojë motivet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve, dhe ndikimin e dhunës në punën e tyre profesionale.

Objektivat e hulumtimit

Objektivat të cilat dëshiron t'i arrijë ky punim janë:

1. Të konstatojë se a ka ndikuar dhuna dhe kërcënimet në punën e gazetarëve;
2. Të identifikojë motivet dhe shkaqet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve;
3. Të konstatojë se si është reflektuar dhuna në punën e tyre;
4. Të verifikojë se a kanë vazhduar gazetarët e dhunuar me tema të njëjta hulumtuese apo kanë kaluar në vetëcensurë;

5. Të zbulojë se a janë zhgënjyer me profesionin e gazetarit dhe me mjedisin mediatik në të cilin punojnë të intervistuarit;
6. Të identifikojë nëse ata mendojnë se janë mbrojtur/përkrahur nga institucionet;
7. Të kuptojë se a kanë menduar që ta braktisin profesionin.

Pyetjet kërkimore

1. A ka ndikuar dhuna dhe kërcënimet në punën e gazetarëve?
2. Sipas tyre cilat kanë qenë motivet e dhunës dhe kërcënimeve?
3. A kanë vazhduar me tema të njëjta hulumtuese apo kanë kaluar në vetëcensurë?
4. Si është reflektuar kërcënimi/dhuna në punën e tyre?
5. A janë zhgënjyer me profesionin e gazetarit dhe me mjedisin mediatik në të cilin punojnë?

Metodat shkencore të punës

Për hartimin e punimit janë përdorur metoda të kombinuara shkencore, cilësore e sasiore, pasi që këto cilësohen si metodat kryesore të punimit, të cilat gjejnë përdorim të gjerë edhe në hulumtimet shkencore për media, gazetari dhe komunikim.

Metoda e intervistimit – është metoda kryesore e hulumtimit në punim e cila është përdorur për të nxjerrë rezultate të matshme lidhur me ndikimin e dhunës ndaj gazetarëve, dhe pasojave të dhunës e cila ndikon në punën profesionale të tyre si gazetarë. Janë planifikuar të realizohen afro 10 intervista me gazetarë, prej të cilave janë realizuar 7 sosh për periudhën kohore 2017-2021.

Metoda përshkruese - është përdorur për shtjellimin teorik të temës dhe shqyrtimin e literaturës përkatëse. Përmes kësaj metode, është paraqitur koncepti i dhunës ndaj gazetarëve si nocion i ndërlidhur me dokumentet e para të lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe me ligjet e shtetit të cilat sigurojnë demokracinë duke filluar nga kushtetuta si akti më i lartë i një shteti.

Metoda e analizës - Kjo metodë është shfrytëzuar për thelbin e punimit. Përmes kësaj metode janë analizuar 7 raste të sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe profesionistëve tjerë të medias nga viti 2017 deri në vitin 2021. Përmes analizës janë identifikuar motivet dhe shkaqet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Përmes analizës janë vendosur përfundimet lidhur me ndikimin e dhunës në aspekte të ndryshme ndaj gazetarëve. Përmes analizës janë nxjerrë edhe rekomandimet që dalin nga punimi.

LITERATURA

- Abrashi, G., & Sallauka, U. (2022). Use of Information Technology in Academic Library Practice. *The International Information & Library Review*, 54(4), 380–386.
<https://doi.org/10.1080/10572317.2022.2124834>
- Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK (2017-2021), Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve,
<https://www.agk-ks.org/rastet/>
- Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK (2019), Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve 2018. <https://www.agk-ks.org/publikime/raporti-treguesit-e-nivelit-te-lirise-se-mediave-dhe-sigurise-se-gazetareve-2018/>
- Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK (2020), Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve 2019. <https://www.agk-ks.org/publikime/treguesit-e-nivelit-te-lirise-se-mediave-dhe-sigurise-se-gazetareve-2020/>
- Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK (2021), Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve 2020. http://www.agk-ks.org/site/assets/files/2678/kos-al_2020.pdf
- Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK (2022), Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve 2021. <https://www.agk-ks.org/publikime/treguesit-e-nivelit-te-lirise-se-medias-dhe-sigurise-se-gazetareve-2021/>
- Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës - (AMPEK), <http://ampek.org/>
- Berisha, Ibrahim (2015). E drejta për shprehje të lirë në normën e Kosovës.
<https://core.ac.uk/download/pdf/143966365.pdf>
- Brambila, J. A., & Hughes, S. (2019). Violence against journalists. *The international encyclopedia of journalism studies*, 1-9.
- Carlsson, Ulla dhe Pöyhtäri, Reeta, Nordicom / UNESCO (2017), The Assault on Journalism,
<http://www.unesco.se/wp-content/uploads/2017/04/The-Assault-on-Journalism.pdf>
- Constitution of the United States. (1787). <https://constitution.congress.gov/constitution/amendment-1/>
- Communication, 2020. Violence against Journalists.
<https://communication.iresearchnet.com/journalism/violence-against-journalists/>
- Cottle, S. (2018, December 19). Journalism coming of (global) age, II.
<https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/1464884918807030>
- Declaration of Human and Civic Rights of 26 August 1789. (2002). Declaration of Human and Civic Rights. https://www.conseil-constitutionnel.fr/sites/default/files/as/root/bank_mm/anglais/cst2.pdf
- Duriqi, Visar (2022), Intervistë, portali Insajderi (i sulmuar në shkurt 2021), <https://www.agk-ks.org/rastet/sulm-fizik-ne-drejtimit-te-gazetarit-visar-duriqi-prishtine-25.02.2021/>

European Convention on Human Rights ECHR (1953), Article 10 - Freedom of Expression, https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf

Fetoshi, Arben. (2018). Media dhe integrimi evropian. Prishtinë: Orfeu.

Freedom House. (n.d.). Kosovo. <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>

Gashi, Mejreme (2022), Intervistë, Klan Kosova (e sulmuar në nëntor 2019), <https://www.agk-ks.org/rastet/sulm-fizik-ndaj-gazetares-mejreme-gashi-prishtine-07.11.2019/>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2008). Ligji Nr. 02/L-65 Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2503>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2012). Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2012). Ligji Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2812>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2012). Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2809>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2013). Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8864>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2018). Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2019). Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2724>

Hajdari, Una (2020). Gazetarët e zhdukur të Kosovës. Kosovo 2.0. <https://kosovotwopointzero.com/gazetaret-e-zhdukur-te-kosoves/>

Hobbes, Th. (1651). Hobbes's Leviathan H_Sz_ - Online Library of Liberty. https://files.libertyfund.org/files/869/0161_Bk.pdf

Hume, D. (n.d.). David Hume on Freedom of the Press. Afterall.net. <https://afterall.net/quotes/david-hume-on-freedom-of-the-press/>

Kajtazi, Shkumbin (2022), Intervistë, portali Reporteri (i sulmuar në tetor 2020), <https://www.agk-ks.org/rastet/kercenim-ne-drejtim-te-gazetarit-shkumbin-kajtazi-mitrovice-18.10.2020/>

Kelmendi, Xheladini, Norë, Intervistë, portali Ekonomia Online (e sulmuar në tetor 2019), <https://www.agk-ks.org/rastet/sulm-fizik-ndaj-gazetares-nore-kelmendi-prishtine-28.10.2019/>

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. <https://presscouncil-ks.org/>

Komisioni i Pavarur për Media. KPM (2022). Licencimi i Shërbyesve Medial Audiovizuel. <https://kpm-ks.org/telicencuarit/305/licencimi/305>

- Kosovalive (2021). Siguria e gazetareve në raportimin e korrupsionit në Kosovë.
<https://kosovalive.org/2021/02/26/siguria-e-gazetareve-ne-raportimin-e-korrupsionit-ne-kosove/>
- Kosovo Report 2021. (n.d.). European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations.
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2021_en
- Kovach, B and Rosenstiel, T. (2007). The Elements of Journalism.
https://www.academia.edu/5629536/The_Elements_of_Journalism_BILL_KOVACH_AND_TOM_ROSENSTIEL
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. (2008). Neni 40 - Liria e Shprehjes dhe Neni 42 - Liria e Medieve. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>
- Media and democratic culture. (1999). <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-ViewHTML.asp?FileID=8666>
- Mendel, T. (2003). *Freedom of Information as an Internationally Protected Human Right*.
<https://www.article19.org/data/files/pdfs/publications/foi-as-an-international-right.pdf>
- Milton, J. (1644). *Areopagitica; a Speech of Mr. John Milton*.
https://milton.host.dartmouth.edu/reading_room/areopagitica/text.html
- Nerone (1994), Violence against Journalists. (n.d.). Obo.
<https://www.oxfordbibliographies.com/display/document/obo-9780199756841/obo-9780199756841-0266.xml>
- OHCHR. (n.d.-a). International Covenant on Civil and Political Rights (1966).
<https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>
- OHCHR. (n.d.-b). OHCHR | 2. American Declaration of the Rights and Duties of Man (1948).
<https://www.ohchr.org/en/resources/educators/human-rights-education-training/2-american-declaration-rights-and-duties-man-1948>
- Olluri, Parim (2022), Intervistë, portali Insajderi (i sulmuar në gusht 2017), <https://www.agk-ks.org/rastet/sulm-fizik-parim-olluri-prishtine-16.08.2017/>
- Ramaj, Saranda (2022), Intervistë, KTV (e sulmuar në dhjetor 2017), <https://www.agk-ks.org/rastet/frikesim-kercenim-verbal-saranda-ramaj-peje-19.12.2017/>
- Reporters Without Borders (RSF), (2021), RSF. https://rsf.org/en/analyse_regionale/508
- Rexhaj, Albulena (2022), Intervistë, Kanal 10 (e sulmuar në vitin 2021), <https://www.agk-ks.org/rastet/sulm-ndaj-gazetares-albulena-rexha-mitrovice-e-veriut-13.10.2021/>
- Saliu, H. (2022). Rethinking Media Diplomacy and Public Diplomacy Towards a New Concept: Digital Media Diplomacy. *Online Journal Modelling the New Europe*, 39, 1-24. DOI: [10.24193/OJMNE.2022.39.01](https://doi.org/10.24193/OJMNE.2022.39.01)

- Saliu, H., Rexhepi, Z., Shatri, S. & Kamberi, M. (2022). Experiences with and risks of internet use among children in Kosovo. *Journal of Elementary Education*, 15(2), 145–164. <https://doi.org/10.18690/rei.15.2.145-164.2022>
- Saliu, H., Bicaj, A. (2022). The Digital Competence of Future Teachers in Kosovo. In L. Tomczyk & L. Fedeli, (eds), *Digital Literacy for Teachers. Lecture Notes in Educational Technology*. Springer, Singapore. (275-290). https://doi.org/10.1007/978-981-19-1738-7_15
- Saliu, H. (2022). Public Diplomacy or Public Glocalization? Rethinking Public Diplomacy in the post-Truth Era. *Vestnik Moskovskogo universiteta. Seriya 10. Zhurnalistika*, 1, 157-175. DOI: [10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175](https://doi.org/10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175)
- Saliu H. & Lljunji V. (2022). Cultural Diplomacy of Kosovo after the Declaration of Independence. *Information & Media*, 93, 62-76. <https://doi.org/10.15388/Im.2022.93.61>
- Saliu, H. (2021). The specifics and complexity of EU public diplomacy. *Druzboslovne Razprave*, XXXVII(96–97), 189–207. <https://www.sociolosko-drustvo.si/wp-content/uploads/2021/09/DR96-97-Saliu-WEB.pdf>
- Siebert, Fredrick S., Peterson, Theodore and Schramm, Wilbur (1963), *Four Theories of the Press*. (n.d.). Google Books. https://books.google.nl/books?id=4Q-oePDdcC8C&redir_esc=y
- Simon, Joel. (2014). *The new censorship: Inside the global battle for media freedom*. New York: Columbia Univ. Press. <https://academic.oup.com/columbia-scholarship-online/book/18874?login=false>
- The Western Balkans | Fact Sheets on the European Union | European Parliament. (2022, October 1). <https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/168/the-western-balkans>
- U.S. Department of State (2021). 2021 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo. <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>
- United Nations. (n.d.). Universal Declaration of Human Rights. <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>
- Waisbord, S. (2016, September 14). Antipress Violence and the Crisis of the State. <https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/1081180X0200700306>